



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 128
Prishtinë, më 13 qershor 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 QERSHOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Burim Ramadani, Gëzim Kelmendi, Halit Krasniqi, Sadri Ferati, Albana Gashi, Donika Kadaj-Bujupi, Justina Shiroka-Pula, Rita Hajzeraj-Beqaj, Liburn Aliu, Teuta Haxhiu dhe Ganimete Musliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se cili është dokumenti me të cilin janë betuar ministrat dhe zv/ministrat e Kosovës, çfarë dokumenti nënshkruajnë ata në lidhje me besnikërinë që duhet ta tregojnë ndaj shtetit të Kosovës. Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Sahatqija, në pyetjen me shifrën DO-1740, parashtruar ministrit Nenad Rashiq, tha se ka marrë përgjigje me shkrim nga ministri.

Deputeti Milivoje Stojanović parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se qytetarët, të cilët i kanë regjistruar automjetet e tyre me targa të përkohshme vitin e kaluar, me rastin e vazhdimit të regjistrimit, a duhet të paguajnë akcizë dhe tatim shtesë në komunat Novobërdë, Partesh, Ranillug, Klllokot, si dhe në Gjilan dhe Kamenicë.

Ai gjithashtu parashtroi pyetje për ministrin Rexhepi në lidhje me atë se sa po zbatohet marrëveshja me Serbinë lidhur me lirinë e lëvizjes.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Milivoje Stojanović.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
6. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare të mëparshme

Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 31 maj 2013 pa asnjë vërejtje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj rregullon eksportin, importin, transitin, transngarkesën dhe ritransferin e mallrave strategjike.

Në vazhdim, ai theksoi se ky ligj do të zbatohet në të mirë të avancimit të sigurisë kombëtare dhe të interesave të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, në të mirë të zbatimit dhe plotësimit të marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe mallrave tjera strategjike për qëllime ushtarake, si dhe për të kontribuar në angazhimet regjionale dhe ndërkombëtare të menaxhimit të tregtimit me mallra strategjike.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ramiz Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit

Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, si dhe Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin produktet e ndërtimit.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0 .

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për produktet e ndërtimit.

6. Zgjedhja e një anëtar të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad oc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media ia shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Arsyetimin e raportit me rekomandime, në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaku.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Behar Selimi,
2. GP LDK - Afërdita Berisha-Shaqiri,
3. GP Vetëvendosje - Afrim Hoti,
4. GP AAK - Ramiz Kelmendi,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Jeton Svirca,
6. GP - SLS - Jasmina Zhivković,
7. GP “6+” - Duda Balje dhe
8. GP ‘ZB’ - Milivoje Stojanović.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Afërdita Berisha-Shaqiri.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 71 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 32 fletëvotime. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Drita Lulaj-Berisha ka fituar 18 vota, ndërsa Ilmi Alili ka fituar 21 vota.

Kryetari konstatoi se, në bazë të rezultatit të votimit të fshehtë, Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I

1. Kandidatët e propozuar për anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, znj. Drita Lulaj-Berisha dhe z. Ilmi Alili, nuk i morën votat e nevojshme për t’u zgjedhur anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

2. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerrë shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtarë nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 16:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale